



PROVINCIA AUTONOMA DI TRENTO

Dipartimento Istruzione, università e ricerca
Servizio per lo sviluppo e l'innovazione
del sistema scolastico e formativo
Ufficio di coordinamento pedagogico generale

Mirëse vini në çerdhe

Benvenuti al nido in lingua albanese



F.I.O.R.E.
FAMIGLIA, INFANZIA,
ORIENTAMENTI,
RIFLESSIONI EDUCATIVE
0-3 ANNI

PROVINCIA AUTONOMA DI TRENTO
Dipartimento Istruzione, università e ricerca
Servizio per lo sviluppo e l'innovazione
del sistema scolastico e formativo

Mirëse vini në çerdhe

Benvenuti al nido in lingua albanese



F.I.O.R.E.
FAMIGLIA, INFANZIA,
ORIENTAMENTI,
RIFLESSIONI EDUCATIVE
0-3 ANNI

Famiglia Infanzia Orientamenti Riflessioni educative - 0-3 anni
© Provincia autonoma di Trento – 2012
Dipartimento Istruzione, università e ricerca
Servizio per lo sviluppo e l'innovazione del sistema scolastico e formativo

A cura dell'Ufficio di coordinamento pedagogico generale
Miriam Pintarelli, Anna Tava
Collaborazioni
Monica Dalbon
Maria Fauri

Referenze fotografiche dai nidi d'infanzia
Comuni *Aldeno, Avio, Pomarolo, Tiarno, Riva, Volano, Trento*
Cooperative *Bellesini, Città Futura e Pro.Ges.*

Contributi

Antonio Mazza, direttore Unità Operativa Pediatrica "Valle del Noce" - Cles

Giuseppe Demattè, pediatra I.s. Distretto Centro Nord - Trento

Elena Anzelmo, psicologa, Dottore di ricerca Facoltà di psicologia dello sviluppo,
Università di Milano

Lucia Carli, professore ordinario Facoltà di psicologia dello sviluppo, Università di Milano

Barbara Ongari, professore associato di Psicologia dello Sviluppo e dell'educazione -
Università di Trento

Emanuela Paris, neuropsichiatra infantile, responsabile tecnico scientifico del Servizio di
Logopedia APSP "De Tschiderer" - Trento

Paola Venuti, professore ordinario Facoltà di Scienze Cognitive - Università di Trento

Stampa Litotipografia Alcione - Lavis (Trento)

BENVENUTI

al nido / [a cura dell'Ufficio di
coordinamento pedagogico generale,
Miriam Pintarelli, Anna Tava]. - Trento :
Provincia autonoma di Trento, 2012. - 95 p.
: ill. ; 24 cm. - (FIORE)

Nome dei cur. dal verso del front.

1. Asili nido - Guide per genitori 2. Bambini
- Educazione I. Trento (Provincia). Ufficio
di coordinamento pedagogico generale II.
Pintarelli, Miriam III. *Tava, Anna*
372.218

BENVENUTI AL NIDO

VERSIONE PLURILINGUE (in lingua albanese)

Collaborazioni

Adattamento e selezione testi
Grazia Modugno, Anna Tava

Traduzioni

Segreteria Generale della Provincia - I.S. per la realizzazione di grandi eventi
Cooperativa Città Aperta - Rovereto

Stampa Centro Duplicazioni PAT
Agosto 2012

Indeks

Të imagjinojmë	5
Të mbrojmë dhe kurojmë <i>Të pyesim pediatri</i>	7
Ju bëftë mirë! <i>Të pyesim pediatri</i>	13
Ndarja dhe ribashkimi <i>Të pyesim psikologun</i>	19
Të luajmë dhe të mësojmë rreth botës <i>Të pyesim psikologun</i>	23
Të jesh dhe të flasësh për vehten <i>Të pyesim neuropsikiatrin</i>	29
Frikë dhe siguri <i>Të pyesim psikologun</i>	35
Si është në çerdhe <i>Të pyesim edukatoren</i>	41
Çerdhet në Trentino	49
Hapësirë personale	54



Të imagjinojmë

Imagjinojmë një grup prindërisht të ngjashëm me ju

Ata kanë djem apo vajza të moshës nga 3 muajsh deri në 3 vjeç, për disa prej tyre është përvoja e parë prindërore, disa të tjerë kanë një fëmijë më të madh ose presin një fëmijë tjetër. Këta prindër i çojnë ose do të çojnë fëmijët e tyre në çerdhe, ku ata janë të sigurtë që do të gjejnë një ambient të përshtatshëm për nevojat e dëshirat e tyre dhe njerëz që dinë të qëndrojnë me fëmijët, të përgatitur për të dëgjuar, të aftë për të trajtuar lotët dhe buzëqeshjet, dhe shumë gjëra të bukura për të mësuar dhe ndarë me fëmijën e tyre. Le të imagjinojmë se duke u përfshirë në një aventurë të përbashkët i bën këta të rritur të gatshëm për tu hapur, për të folur në lidhje me ta, për të treguar dyshimet dhe kuriozitetet që ata kanë.

Imagjinojmë që në këtë vend, për të nxitur dëshirën për dialog, mbërrin edhe një burrë apo grua që janë persona të aftë e të zgjuar

Të mençurit apo të urtit janë ata njerëz që dinë shumë gjëra, kanë lexuar libra të mëdhenj, kanë parë shumë fakte dhe dinë sekretet dhe strategjitë, kështu që dinë të interpretojnë kuptimin e gjërave.

Dhe kështu njeriu i urtë ulet midis prindërve të tij dhe thotë: "Pra, çfarë donit të më pyesnit?"

Kalon një moment, disa shikime pyetese, cili fillon?

Pastaj secili clirohet nga shqetësimet e tij, të mëdha ose të vogla nuk ka rëndësi, dhe biseda fillon dhe vazhdon, ndonjëherë duke u lidhur me pyetjen e mëparshme.



Të mbrojmë dhe të kurojmë

Le te pyesim pediatri

Kam dyshime se si të vesh fëmijën... Të vegjëlit kanë nevoja të ndryshme nga ne të rriturit ?

Eshtë instiktive të mendosh se fëmija i porsalindur është më i ndjeshëm ndaj të ftohtit, në të vërtetë kjo është e vërtetë vetëm në ditët e para të jetës, më pas fëmija është në gjendje të ruaj temperaturën e trupit konstante si një i rritur. Prandaj është e gabuar t'a veshësh shumë rëndë, sidomos nëse jetohet në ambiente tepër të nxehta. Natën është mirë që fëmija mos të mbulohet shumë për të shmangur probleme me gjumin, duke kujtuar që temperatura e ambientit të mbahet rreth 18 gradë. Këshillohet të zgjidhni veshje të thjeshta me masa të rehatshme, që favorizojnë veshjen, lëvizjen dhe qarkullimin e gjakut. Gjithashtu është mirë të përdoret kapele kur e ekspozoni fëmijën në diell dhe kapuç në dimër.

Daljet në ambiente të hapura kur është nxehtë apo ftohtë, bëjnë mirë?

Për foshnjat dhe fëmijët është shumë e rëndësishme dalja në ajër të pastër dhe të freskët. Ekspozimi i diellit, në veçanti, stimulon prodhimin e vitaminës D, thelbësore për kalcifikimin e kockave si dhe për një aksion ripërtëritës/rigjenerues të lëkurës. Orët e preferuara ndryshojnë sipas stinëve; në verë janë orët e para të mëngjesit dhe gjysma e dytë e orëve të pasdites, të pajisur ndoshta me një krem dielli me mbrojtje të plotë ose të lartë; ndërsa gjatë stinëve të tjera është mirë që spostimet të bëhen në orët qëndrore të ditës. Së fundmi, është e preferueshme të zgjidhen vende të qeta, të pasura me parqe dhe larg nga trafiku dhe ndotja e ajrit.

Pasi ka filluar të shkojë në çerdhe, vajza ime sëmuret shpesh...

Infeksionet e përsëritura, kryesisht në rrugët e sipërme të frymëmarrjes (ftohjet e zakonshme), janë shumë të shpeshta në moshën pediatrike dhe zakonisht ndodhin pikërisht me socializimet e para të fëmijës, me hyrjen e tij në çerdhe ose në kopësht. Fëmija hyn në kontakt me shumëllojshmëri virusesh

dhe bakteresh që gjenden në mjedis, ndërsa sistemi i tij imunitar është akoma kryesisht i papjekur: mund të ketë rrugët e frymëmarrjes ende mjaft të ngushta, gjë që favorizon akumulimin e sekrecioneve dhe lehtëson përhapjen e mikrobeve; gjithashtu edhe një "dobësi" fiziologjike të refleksit të kollës të cilat shërbejnë për të eliminuar sekrecionet nga trakti respirator, bën që mukusi të mbetet në vend. Duke bërë disa përjashtime, në vitet e para të jetës mund të konsiderohen normale disa episode të ftohjes ato që zgjidhen brenda disa ditëve pa komplikime të veçanta.

Si të menaxhojmë sëmundjet në lidhje me kthimin në çerdhe?

Në interes të fëmijës të sëmurë, si edhe për të mbrojtur shëndetin e fëmijëve të tjerë të shëndetshëm, është thelbësore që fëmija të qëndrojë në shtëpi kur ka temperaturë më të lartë se 38 gradë ose kur tregon simptoma që e pengojnë atë të marrë pjesë në aktivitetet shkollore (pafuqi, vështirësi në frymëmarrje, dhimbje të barkut, vjellje, diarre). Është mirë që fëmija të qëndrojë në shtëpi deri në shërimin e plotë të shëndetit të tij. Një pranim i tij në çerdhe në gjendje shëndetësore jo plotësisht të shëruar ekspozon shokët/shoqet e tij në rrezik të lartë infeksioni dhe e vë vetë fëmijën në kushte të mundshme për t'u risëmurrur me pasoja të rënda. Mund të shfaqen gjithashtu komplikime të vonuara edhe në sëmundjet që nuk janë veçanërisht serioze por që nuk kurohen mirë si për shembull, otit (dhimbje veshi) të cilat, nëse injorohen mund të sjellin një rënie në aftësinë e dëgjimit edhe pas disa vitesh.

Problemi ynë është si t'a bëjmë të flejë.

Ritmi i gjumë-zgjimit të fëmijës gjatë muajve të parë të jetës është shumë e ndryshme nga ajo e një të rrituri, në këtë fazë ai nuk njih dallimin midis ditës dhe natës, ritmi i tij është i pavarur nga ambjenti dhe rregullohet nga nevojat e brendshme që lidhen me urinë dhe etjen. Pas 4 muajsh, gradualisht përshtatet me ritmet e jashtme dhe zakonet e rregullta e ndihmojnë për të sinkronizuar ritmin e brendshëm dhe të jashtëm dhe të përqëndrojë gjumin në orët gjatë natës.

Ndërkohë, nuk do të shkojë në shtrat...

Ja disa këshilla të mira. Është e përshtatshme që fëmija të pijë qumështin e nënës sa më vonë të jetë e mundur në mbrëmje,

në mënyrë që të flejë i ngopur sa më gjatë. Nëse fëmija qan ose zgjohet duke qarë, kontrolloni nëse është i djersitur, nëse ka etje apo pelenën e pisët, por mos e lëvizni fëmijën nga krevati i tij. Mbajini atij dorën ose përkëdheleni duke e bërë atë të ndihet i sigurtë me praninë tuaj. Mbani dritën e dhomës të ulët për të lehtësuar rifillimin e gjumit.

Në vitin e parë të jetës, një masazh apo dush (ose vaskë) para se të vendosni fëmijën tuaj në shtrat për të fjetur, mund të ndihmojë me gjumin.

Rreth mbrëmjes është më mirë të ngadalësohet ritmi i lojrave duke e çuar fëmijën në një gjendje të qetë para-gjumi, në të cilën është bukur të dëgjojë vjersha me ritme të ngadalta dhe melodioze, dhe për fëmijët më të rritur, përralla, por pa përmendur ndonjëherë emërtimin shtrigat, magjistarët apo ujqër të këqinj. Tregojini ato histori apo tregime qetësuese të cilat nuk lënë asnjë tension.

Është e vërtetë se kapëza ose biberoni shkatërron dhëmbët?

Për fëmijën akti i thithjes së gjirit, kapëzës, biberonit apo gishtit është spontan dhe ka një qëllim ushqyes. Akti i thithjes shkakton një mekanizëm kompleks të tipit neuroendokrine që ndihmon tretjen dhe përmirëson asimilimin e ushqimeve. Thithja paraqet gjithashtu një mënyrë ngushëlluese që ofron ndjesi të këndshme. Duhet thënë, gjithësesi, se përdorimi i kapëzes ose i biberonit duhet të kufizohet në kohë edhe pse nuk ekziston një moment i saktë për të ndaluar përdorimin e tyre.

Atëherë kur të hiqet dhe mbi të gjitha, si?

Rreth 2 vjeç, fëmija ka tendencën për t'a lënë kapëzën spontanisht, por nëse kjo nuk ndodh është mirë të shmanget ndarja në mënyrë të papritur dhe traumatike. Prindërit mund të gjejnë mënyrën për të zvogëluar gradualisht përdorimin duke i ofruar kapëzën ose biberonin vetëm në raste shqetësimi apo lodhje.

Por kur është momenti më i mirë?

Koha për të lënë kapëzën nuk është e njëjtë për të gjithë, nuk ka një moment të caktuar. Shpesh ka fëmijë që thithin kapëzën duke luajtur, kur janë thjesht duke ecur apo edhe kur ata janë duke biseduar me prindërit, në këto raste nuk kanë nevojë për biberon në gojë, përkundrazi! Ne mund t'i themi fëmijës: "Më

jep kapëzën kështu që mund të më flasësh më mirë "ose" Tani kapëzën m'a jep mua, do të t'a jap kur të jesh lodhur së luajturi". Me pak fjalë, menaxhimi dhe reduktimi i përdorimit të kapëzës i takon të rriturit apo prindërve.

Më thonë se fëmija në moshën 2 vjeç duhet të fillojë të lajë dhëmbët. Mua më duket shpejt!

Smalti i dhëmbëve të sapo mbirë nuk është plotësisht i mineralizuar dhe kjo i bën ata veçanërisht të ndjeshëm ndaj kariesit. Prandaj një higjenë korrekte e gojës qysh në moshë të vogël dhe marrja e një sasive të mjaftueshme të fluorit janë të nevojshme për parandalimin e kariesit të dhëmbëve. Gjatë heqjes së gjirit në gojën e fëmijës mund të formohen karie për shkak të kontaktit të zgjatur të dhëmbëve apo mishrat e dhëmbëve me lëngje të cilat përmbajnë sheqerna, të tilla si, qumështi, ushqimit pluhur dhe lëngje frutash. Për këtë është mirë që fëmija mos të lejohet të flejë gjumë me një biberon me qumësht apo lëng frute në gojë dhe pas çdo pirje gjiri është e nevojshme që të pastrohen dhëmbët dhe mishrat me një leckë të pastër, të lagur. Më pas është mirë që të pastrohen të gjitha sipërfaqet e dhëmbëve të fëmijës, së pari pa përdorimin e pastës, dhe më vonë me pak pastë dhëmbësh e cila shërben vetëm për të pasuruar ndjesinë e freskisë. Por sigurohuni që fëmija nuk do të gëlltisë pastën e dhëmbëve e cila mund të japë probleme gastrointestinale.

Më shqetësojnë aksidentet në shtëpi.

Në praninë e një fëmije është i rëndësishëm "riorganizimi" i apartamentit për të mbrojtur sigurinë e tij, duke hequr stolitë, duke e bërë të paarritshëm detergjentët, duke mbyllur dhe fiksuar mirë kaseta që përmbajnë mjete që janë potencialisht të rrezikshme. Shmangni lënien përreth çfarëdo, instrumenti, ilaçe, produktet për higjenën, kozmetikë dhe parfume, mundësisht t'i vendosni ato në rafte të mbyllura me çelës apo në vende të paarritshme. Mos harroni të hiqni prizat elektrike pas përdorimit, ku është e mundur. Mos të ketë tela elektrike që mund të preken me dorë dhe të përdoren mbulesa plastike, të cilat gjenden në treg, për të mbyllur prizat. Janë të rrezikshme karriget stolatafër dritareve apo ballkoneve. Fëmijët përdorin të gjuajnë me objekte, për këtë arsye mund edhe të ndodhë që të godasin televizorin ose kompjuterin, xhamat e mobiljeve, pasqyrat.

Nëse fëmija bie dhe godet kokën, si të kuptojmë sa rëndë është dëmtuar?

Në qoftë se fëmija godet kokën duhet shqetësuar kur: menjëherë pas apo edhe në një distancë orësh ai ankohet për dhimbje koke të vazhdueshme, probleme me shikimin ose të ekuilibrit ose të vjella të përsëritura, në qoftë se nga veshi apo hunda ka gjakderdhje ose lëngje të tejdukshme; Janë ngjarje të dyshimta edhe të qarët në mënyrë të përsëritur, një ndryshim humori, të folurit apo të lëvizurit në një mënyrë të pazakontë. Sigurisht, nëse fëmijës i bie të fikët apo humbet vetëdijen ose nuk rizgohet duke e tundur me energji ose nëqoftëse gjumi zgjat shumë apo në qoftë se gjumi është ndryshe nga zakonisht, duhet të veprohet sa më shpejt duke e çuar fëmijën menjëherë në spital.

Cilët janë vendet më të rrezikshme?

Kurrë mos e lini fëmijën tuaj të pambikëqyrur në tryezën e ndërrimit dhe para se t'i këmbeni pelenën përgatisni gjithçka që ju nevojitet pranë jush. Nëse largoheni edhe qoftë për një moment, merreni fëmijën tuaj në krah ose vendoseni në dysheme. Lëreni të luajë mundësisht në dysheme! Qysh në muajt e parë fëmija lëviz dhe kthehet. Vendoseni fëmijën tuaj në krevat më barkun lart, më mirë pa jastëk. Zgjidhni një krevat të thjeshtë pa litarë apo objekte që mund të mbysin fëmijën. Kur ju i bëni dush fëmijës suaj mos e lini vetëm për as edhe një moment, për shkak të rëndesës së kokës dhe të muskujve ende të papërgatitur, foshnjët e porsalindura dhe të vogla ende nuk janë në gjendje të ngrejne fytyrën nga uji edhe pse ajo ka një thellësi disa centimetra.

Po përta i përket lojërave?

Fëmija ka tendencën të vendosë çdo gjë në gojë, prandaj mos lini në dispozicion objekte të vogla (me diametër më pak se 4 cm), të tilla si kikirikë, butona, kopësa, karamelle. Mos lejoni kështu lodra me pjesët e ndashme, litarë apo fiongo. Qeset plastike janë të rrezikshme, fëmija mund të luaj duke mbuluar me to kokën dhe duke bllokuar kështu frymëmarrjen.



Ju bëftë mirë!

Të pyesim pediatri

Po i jap gji vajzës time 4 muajshe, e cila pas dy muajsh do të shkojë në çerdhe... është mirë të fillojë me qumështin pluhur?

Sigurisht që jo, qumështi i gjirit është ushqimi më i mirë për vajzën tuaj! Do të plotësojë në mënyrë ekskluzive kërkesat e saj ushqyese për 6 muajt e para të jetës dhe më shumë. Qumështi juaj do të ketë gjithashtu funksionin mbrojtës nga sëmundjet ngjitëse me të cilat fëmija mund të përballet gjatë jetës së përditshme në komunitet, por mbi të gjitha do të vendosë themelet për shëndetin e jetës së saj. Çerdhja është një mik i qumështit të nënës, atje do t'ju garantohet gjithmonë maksimumi i bashkëpunimit në mënyrë që dhënia e gjirit të mund të bëhet.

Po heqja e gjirit, është më mirë të bëhet para se fëmija të shkojë në çerdhe?

Në të vërtetë nuk jemi ne ata që vendosim kur t'ia heqim gjirin fëmijës. Nëse vëmë re fëmijën, ai do të na e tregojë se kur është koha e duhur. Heqja e gjirit është një ngjarje e natyrshme dhe fëmija do të na bëjë të kuptojmë kur është gati. Do të shohim se kur fëmija do të jetë afër 6 muajsh dhe zhvillimi i zorrëve, imunitetit, neurologjik të jetë i përshtatshëm, ju do të doni vetëm t'ia hiqni gjirin. Të përshpejtosh kohën do të ishte frustruese si për fëmijën ashtu edhe për prindërit.

Fakti i të mos qenit prezent në vaktin e drekës nuk më duket gjë e mirë...

Për fëmijën nuk ka vakte kryesorë apo dytësorë. Ai ka mësuar, nëpërmjet ushqyerjes me gji, që të marrë ushqimin që i nevojitet duke iu përgjigjur sinjaleve të brendshme të urisë apo ngopjes. Për fat të mirë ai nuk i njeh sinjalet e jashtme, si p.sh. ora e drekës apo e ora e darkës, kështu që nuk ka asnjë problem të provohet një tjetër vakt në darkë së bashku me të gjithë familjen.

Foshnja tërhiqet shumë nga çfarë shikon në pletën e prindërve dhe do të ishte mirë të fillonte procesin e pasurimit të eksperiencave të të ushqyerit.

Është e vërtetë që ushqimet e gatshme, siç janë ushqimet e homogjenizuara, janë më të sigurta?

Fëmija juaj që në mitër ka eksploruar kuzhinën e nënës së tij nëpërmjet lëngut amniotik. Pastaj, nëpërmjet ushqyerjes me gji, përvoja e tij në shije dhe aroma të ushqimit që ha nëna, zhvillohet më tej. Tani është ai që kërkon një ushqyerje me shije të njohura dhe ne duhet të shqetësohemi vetëm që t'a bëjmë ushqimin të përshtatshëm për t'u përtypur nga fëmija. Ushqimet e gatshme, siç janë ushqimet e homogjenizuara, ishin thelbësore në kohën kur heqja e gjirit ishte e shpejtuar krahasuar me aftësitë, si ato përtypëse ashtu edhe ato tretëse, por tani pritet që fëmija të jetë gati e kështu që nuk janë më të nevojshme. Përveç kësaj, pavarësisht nga reklamimet këmbëngulëse, edhe pse nga pikëpamja e të ushqyerit janë të vlefshme, ushqimet e gatshme kurrë nuk do të përmbajnë shpirtin e të ushqyerit të familjes.

Mund të na sugjeroni një mënyrë për të filluar ushqimin?

Mendoj se një model i vetëm nuk është gjëja më e mirë. Mënyra e të ushqyerit është rezultat i identitetit, i karakterit dhe lidhjes midis fëmijës dhe familjes. Besoj se në periudhën që varion nga gjashtë deri në nëntë muaj është e përshtatshme që fëmija të njohë pjesën më të madhe të ushqimeve. Shijet që fëmija zbulon në familje ose në kopësht gjatë fëmijërisë së hershme do të mbeten përgjithmonë në kujtesën e tij për shijet.

Unë, që jam alergjik ndaj gjërave të ndryshme, pyes veten: a është e drejtë që fëmijës tim t'i jap të gjitha ushqimet?

Shkenca e të ushqyerit konfirmon se fëmija nga 6 deri në 9 muajsh nëse ha çfarëdo lloj ushqimi nuk rrezikon alergji, mos tolerim ushqimi, diarre, inhalimi i trupave të huaja, as më shumë e as më pak se moshatarët e tij një vjeçarë. Sigurisht, duke qenë se në familje ka persona alergjikë, më mirë që të ketë largpamësi për të provuar ushqime të reja në një interval 3-4 ditë, dhe vetëm një për çdo herë.



Më thonë se në çerdhe vajza ime 18 muajshe ha gjithçka, por në shtëpi do vetëm biberonin!

Fëmija në vitin e dytë të jetës ka më pak nevojë për energji dhe gjithashtu interesi i tij për ushqimin dhe shijet e reja është i ulët. Para së gjithash, është për t'u theksuar se sasia e qumështit në këtë moshë nuk duhet të kalojë 500 ml në ditë, ndryshe të gjitha kërkesat ushqimore të tij plotësohen vetëm nga qumështi; Edhe lëngjet e frutave apo pijet e tjera me sheqer nuk janë pjesë e të ushqyerit në mënyrën e duhur. Një propozim i shëndetshëm duhet të marrë parasysh nevojat reale dhe shumëllojshmërinë e ushqimit. Në çerdhe menuja është gjithmonë e mbikqyrur nga dietologu.

Përse me mua tregon mungesë oreksi?

Me siguri përdorimi i tepruar i biberonit - si me qumësht ashtu edhe me lëng frutash - zvogëlon ndjesinë e urisë dhe i jep kalori fëmijës në mënyrë jo të ekuilibruar.

Një faktor i rëndësishëm është edhe se si do të shërbehet ushqimi: vakti i ngrënies duhet përjetuar si një moment qetësie së bashku me të gjithë familjen dhe racionet duhet që të jenë të përshtatshme për fëmijën, i cili nganjëherë frikësohet përpara pjatave të mbushura plot.

Megjithatë, do të mendojnë në çerdhe t'a drejtojnë fëmijën drejt një mënyre korrekte të ushqyerit!

Familja ka një rol të rëndësishëm në këtë fushë. Fëmija i vogël mëson nga sjelljet e familjarëve më shumë se sa nga një mijë fjalë. Është mirë që të gjithë në shtëpi të hanë në mënyrë të shëndetshme duke filluar qysh sa ngrihen në mëngjes, duke i dhënë rëndësi momentit të ngrënies së mëngjezit.

Në mëngjes nuk ka kohë! Është gjithmonë me nxitim...

Zakoni i të ngrënit mëngjesin rregullisht garanton një mirëqenie për të gjitha moshat. Fëmija që frekuenton çerdhen duhet të marrë, midis mëngjesit dhe qëndisë së mëngjesit rreth 20-25% të nevojave kalorike të tij.

Mëngjesi duhet të sigurojë një ekuilibër të ushqimeve që mund të ndryshojnë, por që të japin energji për të përballuar ditën sa më mirë si: qumësht i paskremuar ose produkte të tjera të qumështit, bukë, reçel, fruta të freskëta në copëza të vogla, kek i bërë në shtëpi, etj.

Djali im është 2 vjeç dhe ha gjithçka, madje më shumë nga ç'duhet!

Përdorimi i perimeve, frutave, drithërave integralë ndihmon të mbajë një peshë të shëndetshme dhe korrekte. Menutë në çerdhe ofrojnë ushqime që i japin fëmijës vlera ushqyese të duhura. Në fakt, është demonstruar një lidhje midis një tejkalim i proteinave në vitet e para të jetës dhe zhvillimit të obezitetit pas moshës tetë vjeç.

Pra, më mirë le t'i vendosim sa më herët zakonet e mira!

Si fillim të hahet mëngjesi të gjithë së bashku duke mos lënë kështu fëmijën vetëm përpara kupës. Të eliminohet biberoni! Qumështi dhe lëngjet e frutave të ngrëna me këtë metodë, sjellin shumë kalori në një kohë të shkurtër dhe e bëjnë fëmijën të prirur për prishjen e dhëmbëve nga biberoni. Kur ai kthehet në shtëpi, në qoftë se ka bërë tashmë një meze të lehtë, është mirë t'i ofrohet fruta të copëtuara, e ndonjëherë kos apo ëmbëlsira të thjeshta me fruta. Për darkë, menyja duhet të jetë e ngjashme për të gjithë, megjithëse me ushqime të përshtatshme për mundësinë e përtypjes së gjithësecilit; natyrisht duhet pasur parasysht atë që është konsumuar në drekë.



Ndarja dhe ribashkimi

Të pyesim psikologun

Më duhet të kthehem në punë, kaq shpejt... fëmija im do të vuajë?

Varet nga mosha e fëmijës, por sidomos se si situata përjetohet nga nëna dhe se si kjo situatë i paraqitet pastaj fëmijës. Nëse është e mundur, është e preferueshme që ndarja të zhvillohet pas një viti të jetës, sidoqoftë ndarjet e mësipërme - nëse menaxhohen siç duhet - nuk shkaktojnë vuajtje, përkundrazi, mund të jetë një përvojë e rritjes, si për fëmijën ashtu edhe për prindërit e tyre. Është me rëndësi që prindërit të gjejnë një zgjidhje lehtësuese për të përballuar ndarjen graduale nga fëmija i tyre. Është e rëndësishme të identifikojnë një person (mësuesen, gjyshen, babysitter, etj.) me të cilat do të ndërtojnë një marrëdhënie besimi dhe të ndjejnë se është e mundur të komunikojnë hapur shqetësimet dhe emocionet e tyre.

Çfarë mund të jetë e dobishme për të bërë?

Fillimisht është e rëndësishme prania e prindit dhe fëmijës brenda në çerdhe. Është e nevojshme një njohje reciproke, në mënyrë që të ruhet një vazhdimësi e ritmeve dhe zakoneve për të rregulluar gradualisht emocionet lidhur me shkëputjen e parë. Gjithashtu është e rëndësishme edhe koha që prindërit mund t'i dedikojnë fëmijës së tyre pas punës dhe se si ata mund t'a okupojnë atë me fëmijën e tyre.

Si t'ia shpjegoj fëmijës se duhet patjetër t'a lë me persona të tjerë?

Nëse fëmija është i vogël nuk është e lehtë për të justifikuar mungesën e prindit, megjithatë mos të heqim dorë për t'a bërë këtë, duke i'a komunikuar me sinjale të shumta si p.sh.: duke shoqëruar hyrjen dhe daljen me gjeste dashurie dhe me pak fjalë e shpjegime, të cilat fëmija do të marrë fillimisht vetëm anën emocionale, por nga kjo do të perceptojë kuptimin e mesazhit.

Praktikisht, çfarë mund të bëj?

Ju mund të gjeni gjëra rutinë për të bërë me fëmijën, si para se të niseni nga shtëpia (p.sh. një lojë të vogël), ashtu edhe menjëherë pas kthimit të tij (p.sh. përgatitjen e një meze të lehtë). Gradualisht fëmija do të shoqërojë rutinën e parë me të dytë, me ikjen e prindit kthimin e tij të sigurtë.

Në çfarë mënyre?

Mund të rezultojë, për shembull, qetësuese për fëmijën që të marrë me vete nga shtëpia për në çerdhe një objekt që ai e pëlqen shumë dhe se çdo ditë mund të largohet dhe t'a gjejë atë në të njëjtin vend.

Fëmija kështu mund të përjetojë dinamikën e ikjes dhe kthimit, të lënjes dhe të gjetjes.

A do të jenë kaq të kujdesshëm në çerdhe?

Në periudhën e parë të pranimit dhe përfshirjen në çerdhe, fëmija do të gjejë cdo ditë të njëjtën pikë referimi dhe gjërat e tij. Nëse prindi e lë fëmijën e tij me një buzëqeshje, duke i'a besuar atë me besim të plotë edukatores, ndarja do të jetë një eksperiencë pozitive; por nëse ai e lë atë me dhimbje, duke u ndjerë në faj sepse i duhet të punojë edhe fëmija do të perceptojë momentin e ndarjes në mënyrë negative.

Domethënë, fëmija i bën të tijat emocionet e një të rrituri?

Nëse prindi ndjen dhe komunikon se përvoja e ndarjes nuk është as e rrezikshme as tragjike, edhe fëmija mund të përjetojë atë si eksperiencë pozitive, duke përmirësuar zhvillimin social dhe të marrëdhënieve dhe me përvetësimin e pavarësisë së tij. Por në qoftë se ka vështirësi në ndarjen, fëmijët mund të shfaqin vështirësi në ritmin e gjumë-zgjimit, në të ushqyer, ose të qajnë shpesh.

E ka kaq të vështirë të shkëputet prej meje, pse?

Vështirësia në ndarje është mjaft e natyrshme.

Ndarja e parë e fëmijëve nga prindërit e tyre është një proces kritik psikologjik. Çdo fëmijë ka gjithashtu kohën e tij të ndarjes: disa prej tyre fillimisht duken sikur nuk kanë vështirësi, por kjo nuk është reagimi më i dëshirueshëm, sepse herët a vonë kriza ndodh, dhe sa më shumë e vonuar të jetë më pak e njohur bëhet nga edukatorët dhe prindërit.

Fëmija duhet të ndihmohet që të ndahet gradualisht dhe me një fleksibilitet në kohë dhe në mënyra, kur dhe si. Por gjithashtu, prindërit duhet të gjejnë forcën për t'u ndarë nga djali apo vajza për t'a lënë atë më figura të tjera referimi, duke ndërtuar me to një marrëdhënie besimi dhe mbështetje.

Djali im nuk do të më lërë të largohem!

Nëse fëmija juaj tregon një përforcim të dëshirës së tij për të patur afër prindin, nganjëherë komunikon në këtë mënyrë vështirësitë e prindit vetë për të përballuar ndarjen. Është e domosdoshme atëherë të jepet përgjigje nevojave të të rriturit duke e siguruar atë mbi idenë që ai ka për veten si prind.

Fëmija im është shumë i turpshëm. Të panjohurit dhe mjediset e reja e trembin. Pse?

Në përgjithësi, të gjithë fëmijët brenda vitit të parë të jetës, kalojnë një fazë ku ata kanë tendencën për të shprehur frikën drejt njerëzve të panjohur.

Kontakti i fëmijëve me mjedisin dhe njerëzit e huaj duhet të shoqërohet dhe ndërmjetësohet nga prindi, fëmija nuk duhet të ndihet i vetmuar. Nëse fëmija ka krijuar një marrëdhënie të sigurtë me prindin, gradualisht mund të përdorë praninë dhe mbështetjen e tij si një bazë e sigurt nga e cila të fillojë të eksplorojë botën.

Ndërsa fëmija im shkon me të gjithë, nuk i dëgjon rekomandimet!

Ka disa fëmijë të cilët janë shumë të hapur me persona të huaj, të cilët kanë tendencë të mos marrin distancat dhe kërkojnë kontaktin me ta. Duke shprehur këtë autonomi qysh në fillim, në të vërtetë, fëmija mund të shprehë nevojën e tij për dashuri. Pyetja pra është nëse qasja pa dallim me persona të huaj mund të shprehë një sjellje reaktive, dmth nevoja për një lidhje të fortë emocionale, që nuk është e kënaqur në marrëdhëniet me prindërit, kërkohet gjetkë.



Të luajmë dhe të mësojmë rreth botës

Të pyesim psikologun

Fëmijët e vegjël dinë si të luajnë së bashku?

Të luash së bashku me moshatarët është shumë e rëndësishme për zhvillimin sepse ajo nxit aftësinë për t'u përballur, për të matur forcën dhe aftësinë për t'iu nënshtruar rregullave për të luajtur së bashku. Në të njëjtën kohë, ka momente në të cilat fëmija, ose për një fazë zhvillimi që jeton ose për kushte të veçanta mjedisore, dëshiron të qëndrojë vetëm, të përqëndrohet dhe të ketë hapësirën e vet pa ndërhyrje të personave të tjerë. Në lojë fëmija mëson, njeh, eksperimenton, krijon, shpik dhe shkarkon impulset, zemërimin dhe frikën e tij.

Fëmija im shpesh luan vetëm: duhet të shqetësohem?

Nëse një fëmijë luan gjithmonë vetëm dhe refuzon të luajë me të tjerët mund të ketë disa arsye: është e mundur që loja në vetmi rrjedh nga një vështirësi i të qëndruarit me të tjerët, ose që ajo është një manifestim i përqendrimit dhe angazhimit të veçantë që ai vë në disa aktivitete specifike. Duhet gjithashtu të pyesim vehten nëse loja që ai bën është e përshtatshme për zhvillimin e tij, nëse ajo është kënaqësi dhe kreativitet, ose nëse ajo është përsëritje, mekanike dhe jo shumë ekspresive. Pra, në qoftë se në një rast nuk ka gjë për t'iu shqetësuar, në anën tjetër duhet të merren masa për të përfshirë vogëlushin në lojëra me të tjerët, madje edhe me të rriturit, dhe në këto veprime do të kërkohet të zgjerohet niveli i aktivitetit dhe të bëhet e mundur që fëmija të përjetojë një emocion lidhur me kënaqësinë.

Nuk është pak e çuditshme që një djalë të luajë me kukulla?

Ekzistenca e lojrave për meshkuj dhe femra është një fenomen shumë social: që të vegjël i shijmë djemtë të bëjnë disa aktivitete dhe vajzat disa të tjera, dhe vetë reklamat ndikojnë në këtë drejtim. Në të vërtetë lojërat kanë një vlerë të caktuar, lidhur me funksionin dhe kuptimin e vërtetë të tyre, ku një shpatë shërben për të luftuar dhe një kukull shërben për të

përjetuar kujdesin për një tjetër. Nuk ka asgjë tjetër përveçse një konventë shoqërore, e cila përkufizon që një diçka të jetë mashkull dhe tjetra femër.

Është shumë e natyrshme që djemtë duke parë shoqet e tyre duke luajtur me kukulla duan t'a provojnë edhe ata të luajnë me to, duke i dhënë zë një nevoje për t'u kujdesur që është sa mashkullore aq edhe femërore. Në të njëjtën mënyrë një vajzë mund të dojë të luajë me shpatë për të treguar vetveten dhe për të matur forcën dhe fuqinë e saj.

Është më mirë t'i lësh të zihen mes tyre apo duhet ndërhyrë?

Zënkat midis vëllezërve dhe motrave apo mes fëmijëve shpesh ngjallin në të rriturit siklet dhe frikë: frikë se fëmija i tyre është i dhunshëm dhe nuk mund të kontrollojë vetveten. Prandaj shpesh lind nevoja të ndërhyet menjëherë për të ndaluar zënkat duke vënë qetësi. Për fëmijët, zënkat janë një mënyrë për t'u rritur, janë një mundësi për të mësuar si të qëndrojnë me të tjerët dhe në të njëjtën kohë për të treguar vetveten.

Atëherë kur duhet ndërhyrë?

Një i rritur duhet të ndërhyjë në zënkë ndoshta më pas, për të ndihmuar fëmijët të reflektojnë mbi arsyet që i shtynë të zihen, për t'i ndihmuar të kuptojnë konfliktin duke lejuar të shprehin ndjenjat e tyre.

Fëmija i vogël e kupton dënimin?

Fëmijët i kuptojnë shumë shpejt rregullat që një prind apo mësues vënë, por disave prej tyre mund tju shpëtojë sensi i dënimit. Unë nuk mendoj se është gjithmonë e nevojshme të përdorësh dënimin ose ndëshkimin. Më tepër se kuptimin e një dënimi, fëmija kupton tonin emocional dhe tonin e humorit të të rriturve. Prandaj është jashtëzakonisht e rëndësishme që prindërit të dinë se si të vënë kufizime në mënyrë të vendosur, pa zemërim por me vendosmëri, dhe të dinë t'i bëjnë ato të zbatohen.

Unë pas disa tekave nuk duroj dot më...

Kufijtë nuk duhet të jetë kurrë shumë, sepse do të ishte e pamundur për t'i zbatuar të gjitha ato, dhe pastaj kur janë aq shumë janë të panevojshme. Por ato që ju duhet të jepen duhet detyrimisht të zbatohen për shkak se në këtë mënyrë

fëmija fiton ndëgjegjësimin e forcës së prindërve të saj dhe të rolit të tij si djalë, të mbrojtur nga prindër të fortë. Me kufij të qartë, fëmija mëson të kuptojë se çfarë janë gjërat që mund të bëjë dhe cilat jo.

Por nëse nuk binden?

Është vërtet shumë e rëndësishme që rregulli të respektohet dhe prindërit duhet të bien dakord, sa është e mundur, në vënien e rregullave që ata ndajnë të dy. Nëse mami thotë se nuk do të blej karamelle duhet të jetë me të vërtetë e vendosur të mos ta bëjë këtë, sepse në qoftë se pasi fëmija ka qarë dhe është hedhur përtokë ajo nga lodhja dorëzohet, mbaroi. Ai fëmijë do të formojë idenë e të qenit më i fortë se prindi i tij sepse për t'i patur gjërat mjafton vetëm të qajë shumë dhe të bëjë skena të shumta.

Ndonjëherë kur shkoj për t'a marrë nuk do të vijë. Pse?

Ndodh që fëmija t'i kërkojë nënës, që shkon për t'a marrë në çerdhe, që të qëndrojë të luajë akoma edhe pak, por nëna përgjigjet menjëherë jo, atëherë fëmija shpesh vazhdon të luajë dhe nuk përgjigjet kur ajo i bërtet që të pushojë dhe të shkojë të vishet. Shumë herë do të ishte mirë që fëmija të lejohet të qëndrojë edhe për pak, sepse kjo korrespondon me nevojën e tij për të parë nënën e tij në vendin ku ai kalon shumë orë, dhe pastaj kur thuhet se duhet të shkoni duhet të shkoni me të vërtetë dhe jo pas një çerek ore.

Karakteri është një faktor gjenetik apo varet nga edukimi?

Karakteri përgjithësisht varet nga personaliteti i fëmijës, dmth nga temperamentit bazë që do të modelohet më vonë nga ambienti relational, fizik dhe edukativ në të cilin do të rritet. Pra, një fëmijë me karakter të fortë dhe kokëfortë patjetër do të ketë një predispozitë për të qenë kështu, por ambienti edukativ dhe lloji i marrëdhënieve që ka krijuar me prindërit e tij mund të rrisë ose të zvogëlojë këtë tipar të karakterit të tij.

Në këtë periudhë djali im thotë "jo" për çdo gjë. Pse?

Rreth moshës dy vjeç është momenti i parë që karakterizohet nga një kundërshtim i fortë në të cilin fjala jo bëhet fjala kryesore e fjalorit të fëmijës. Çdo lloj pyetje i përgjigjet jo, dhe kjo është hera e parë në evolucionin e fëmijës ku ai ose ajo vë

re të jetë diçka ndryshe nga prindërit e tyre, që mund të duan të tjera gjëra nga ato që duan mami apo babi, dhe kështu provojnë një kënaqësi të madhe në këtë deklaratë.

T'a parandalosh këtë sigurisht është e dëmshme: një fëmijë duhet të mësojë të thotë jo dhe në këtë mënyrë të deklarojë vetveten, por është gjithashtu e nevojshme të frenohet kjo fazë. Dmth mund të thotë jo dhe të zgjedhë midis atyre gjërave që nuk janë të dëmshme për të, dhe t'i mohohen ato gjëra nga të cilat duhet mbrojtur.

Fëmija im nuk bie dakord veçanërisht për rrobat...

Nëse fëmija nuk dëshiron të vesh bluzën që i ka përgatitur nëna, dhe në vend të saj kërkon një ngjyrë që nuk shkon me pantallonat, kjo nuk ka rëndësi. Le t'ia lejojmë të zgjedhë vetë veshjen e tij dhe të provojë çfarë i pëlqen. Por në anën tjetër, nëse kërkon të dalë në dimër pa xhaketë, do t'ia parandalojmë. Në këto raste nuk është e nevojshme të thuhet shumë fjalë. Shpesh fëmijët nuk arrijnë të ndjekin shpjegimet e gjata, kështu që është rasti të kuptojë se duhet të bëjë këtë gjë sepse kështu ka vendosur nëna. Fëmija do të protestojë dhe kjo është gjë e mirë, por prindi duhet të vazhdojë t'i thotë me vendosmëri dhe pa u inatosuar se duhet të bëhet si thotë ai ose ajo).

Së shpejti do të lindë një vëlla i vogël. Kur duhet filluar të flasësh për këtë?

Fëmija duhet të përgatitet gradualisht. I duhet thënë sapo të jeni të sigurtë për shtatëzaninë, kur barku nuk duket ende dhe t'i lejoni t'a prekë atë ndërsa rritet. Fëmija duhet gradualisht të familiarizohet me vëllain e vogël akoma pa lindur; mund të flasë me atë, t'i tregojë çfarë ka në botë dhe mund të imagjinojë se si është bota brenda në bark. Padyshim mënyra më e mirë për t'a përgatitur për ngjarjen është që ai të marrë pjesë.

Ka pak që ka vdekur gjyshi, nuk di çfarë t'i them.

Ballafaqimi me vdekjen është një moment delikat dhe i rëndësishëm në jetën e një fëmije. Humbja e parë e një personi të dashur është me të vërtetë e dhimbshme. Kur vdes dikush të cilin fëmija e kishte shumë përzemër është gjithmonë e vështirë për t'ia komunikuar atij këtë, mënyra më e mirë është që t'i flasësh në mënyrë të qartë, të thjeshtë dhe të sigurtë.

Do t'i thuhet atëherë se gjyshi i tij na la, që vdiq dhe se ne do t'a kujtojmë atë përgjithmonë. Pastaj, në varësi të ideve pak a shumë fetare të familjes, mund të flitet për gjyshin e tij që është në qiell ose në parajsë, ose që nuk jeton më një jetë si e jona. Këto shpjegime varen shumë nga vlerat e familjes. Ajo që ka rëndësi është mos t'i genjeni fëmijës dhe të jeni të qetë dhe të vendosur ndërkohë që jepen këto shpjegime. Ju mund të ndihmoni me histori dhe tregime, dhe është mirë t'i lejoni fëmijës të mbajë gjallë kujtimin e personit të humbur duke i folur atij mbi gjërat e bëra së bashku ose të objekteve të tij të mbetura.



Të jesh dhe të flasësh për vehten

Të pyesim neuropsikiatren

Pyes veten nëse pak nga karakteri e ka të lindur...

Çdo prind e sheh shpejt si disa nga aspektet e karakterit të fëmijës së tyre janë shumë personale, por ndonjëherë mund asistojnë në disa ndryshime që bien shumë në sy. Shpesh tek fëmijët njihen elementet e temperamentit të prindit dhe mund të ndodhë gjithashtu se tek ata ne tolerojmë më pak ato që janë të "metat" tona.

Por sa mund të ndryshohet?

Detyra e prindërve është të përpiqen të njohin gjithmonë e më mirë fëmijën e tyre, të respektojnë madje edhe atë që nuk pëlqehet shumë në temperamentin e tij. Ndryshe është situata kur disa aspekte të karakterit duken një pengesë për fëmijën dhe jetën e tij shoqërore; për shembull, nëse është shumë i ndrojtur dhe kjo gjë nuk i lejon atij të luajë me të tjerët është mirë të hetohet më thellë mbi shkaqet e këtij sikleti dhe të gjendet mënyra për t'a ndihmuar, madje edhe duke folur me edukatorët.

Si të kuptojmë nëse ka vonesa në zhvillim?

Zhvillimi i përgjithshëm i fëmijës është një proces shumë kompleks në të cilin ka shumë aftësi që fitohen. Fëmijët nuk arrijnë të gjithë të njëjtat faza në të njëjtin moment, për shembull në zhvillimin motorik të lëvizjeve mund të kemi fëmijë 10 muajsh të cilët tashmë ecin të pavarur dhe disa të tjerë që e bëjnë në moshën 15 muajsh dhe kjo s'duhet të krijojë shqetësime. Ndodh që disa fëmijë të ecin këmba – dorazi për shumë muaj dhe disa të tjerë që nuk e bëjnë fare, dhe kjo është më se normale. Por në qoftë se një fëmijë 18 muajsh nuk ecën ende është e rëndësishme të shikohet rasti. Pra, kur një prind është i shqetësuar se ka një vonesë në lidhje me disa faza të caktuara zhvillimi është e rëndësishme që të bisedojë si me pediatrën ashtu edhe me edukatorët në çerdhe në mënyrë që ata të mund të ballafaqohen dhe të mund të bëjnë krahasime me personat e tjerë që kujdesen për fëmijën.

Është gati 3 vjeç dhe ende nuk e kuptoj çfarë thotë...

Zhvillimi i të folurit është një proces shumë kompleks dhe mund të vëmë re shumë ndryshime nga një fëmijë në një tjetër. Por ka disa hapa "universale" që janë të njëjta për çdo gjuhë dhe tregojnë se si po ecën zhvillimi: rreth 12 muajsh fillojnë të flasin fjalët e para, midis 18 dhe 24 muajsh formojnë frazat e para dhe le të themi që e folura "shpërthen", pra pasurohet shumë shpejt; rreth 3 vjeç fëmijët flasin pothuajse të gjitha frazat e gjuhës së tyre dhe rreth vitit të 4-t kompletohet zotërimi i plotë i tingujve.

Vajza ime kur ishte 2 vjeçe i thoshte të gjitha, por i vëllai jo!

Kur është rreth 2 vjeç, rreth 70% e asaj që një fëmijë thotë është e kuptueshme nga pikëpamja fonologjike. Pra, nëse një fëmijë 3 vjeç ka një të folur të paqartë ose flet pak fjalë dhe fraza, atëherë është e rëndësishme të bisedohet me pediatrin dhe nëse është e nevojshme të konsultoheni edhe me një specialist, i cili do të vlerësojë të folurën në tërësi dhe brenda zhvillimit të përgjithshëm.

Është e vërtetë që ka dallim e folura e meshkujve nga ajo e femrave?

Shumë mendojnë kështu, por studimet mbi zhvillimin e të folurës tregojnë se nuk ka dallime të mëdha, është e vërtetë në fakt se nga fëmijët që kanë vonesa apo çrregullime në të folur, meshkujt zënë përqindjen më të madhe, por për këtë nuk dihen shkaqet. Duhet patur parasysh gjithashtu se disa forma të vonesës në të folur mund të jenë të trashëgueshme dhe mund të ndodhin te disa persona brenda së njëjtës familje.

Fëmija im belbëzon pak ose nuk i thotë më disa fjalë që i dinte tashmë...

Mund të ndodhë që te fëmijët rreth 3 dhe 5 vjeç të jenë të pranishme periudha belbëzimi, kjo nganjëherë ndodh gjatë ngjarjeve stresuese dhe pastaj simptoma mund të ketë një vazhdimësi "ciklike" me periudha përmirësimi dhe përkeqësimi, por në shumicën e rasteve tenton të zhduket rreth moshës 6 vjeç. Është e rëndësishme të mos i krijohet ankth i tepërt fëmijës, t'i lejohet që të përfundojë diskutimin e tij dhe të mos ndërpritet edhe nëse e kemi kuptuar se çfarë do të thotë. Nëse simptoma vazhdon, atëherë është e nevojshme të bisedohet me pediatrin.

Po dygjuhësia? Është gjë e bukur, apo jo?

Tek ne është në rritje numri i fëmijëve dygjuhësh. Kjo është një formë e dygjuhësisë dhe quhet "një gjuhë/një mjedis", sepse fëmijët zakonisht në shtëpi flasin gjuhën amtare të prindërve dhe në hapësirat shkollore në gjuhën vendase. Të gjitha studimet e të folurit tek fëmijët shumëgjuhësh pajtohen me mendimin se kjo është një situatë që nuk pengon zhvillimin. Është treguar gjithashtu se një prindëri arrin të bëjë shumë mirë rolin e prindit kur flet gjuhën e tij amtare. Prindërit e huaj që mund të ndihen të detyruar të flasin italisht rrezikojnë të varfërojnë marrëdhënien me fëmijën.

Fëmija im, sipas meje, është shumë i gjallë...

Fëmijët nga natyra janë gjithmonë të gjallë dhe aktivë dhe kjo u lejon atyre të njohin botën, dhe gjallëria e fëmijëve është edhe një nxitje për të rriturit që përfshihen me ta. Por fëmijët "shumë të gjallë" kanë problemin e të mos qenit në gjendje të eksplorojnë realitetin duke mos e patur kështu vëmendjen për atë që i rrethon. Vëmendja, si aftësitë e tjera, është një proces që ka nevojë të përqendrohet dhe të zhvillohet gradualisht dhe kjo varet jo vetëm nga pjekuria, por edhe nga tipi i përvojave që fëmija bën.

Unë i bërtas vazhdimisht, por nuk më dëgjon...

Në fakt, rreziku është që të qortohet gjithmonë dhe kjo ushqen akoma edhe më shumë nervozizmin e tij. Fëmija duhet të ndihmohet të qëndrojë me kënaqësi mbi gjërat, në aktivitete të shkurtra por të kënaqshme. Ndonjëherë fëmijët tepër të lëvizur janë ata të cilët kanë nevojë për të tërhequr vëmendjen e të rriturve, kështu që është e rëndësishme të përpiqemi të kuptojmë se çfarë mund të jetë shkak i kësaj sjelljeje.

Pra duhet të ndihmojë fëmijën tim që të njohë dhe të shprehë emocionet e tij?

Fëmijët mësojnë shumë herët që të njohin emocionet e tyre kjo edhe për shkak të faktit se prindërit janë të parët që i njohin ato tek fëmija i tyre. Një foshnje e porsalindur akoma nuk e di se ai qan sepse është i uritur, por është nëna ajo që e interpreton këtë qarje dhe ushqen fëmijën, kjo i lejon asaj të dallojë perceptimet që ajo ka dhe të njohë gjendjen shpirtërore të fëmijës. Me kalimin e kohës që fëmijët rriten, është mirë të bisedoni me ta për ndjenjat, emërtimin e tyre kur ato ndodhin"

("po shoh se je i zemëruar ", "kjo gjë të bën kaq të lumtur!"), dhe të nxiten shprehjet e të gjitha emocioneve, si ato pozitive ashtu edhe ato negative, të tilla si frika apo zemërimi.

Kur zemërohet ka kriza shumë të forta që më trembin!

Përpara reagimeve të tepruara të fëmijës, është e rëndësishme, të mos frikësoheni dhe mos të dorëzoheni vetëm për rëniën në sy të sjelljes së tij apo ndjenjës së fajit, por të ndihmoni fëmijën të kuptojë atë se çfarë po ndodh dhe të zhvillojë aftësinë për të toleruar mërzitjet dhe zhgënjimet. Rreth moshës dy vjeç shpesh ka një periudhë në të cilën qëndrimi prej sfide është më i theksuar, e cila përkon me zbulimin e pavarësisë së tyre.

Kur do e kuptojë që rregullat duhen?

Në vitet e para të jetës fëmijët fillimisht "i nënshtrohen" rregullave ose ndalimeve si diçka pak ekuivalente për ta, vetëm më vonë mund të kuptojnë se një ndalim mund të ketë një rol mbrojtës, për shembull, për të shmangur një rrezik. Fëmijët mësojnë shumë rregulla përmes shembullit të prindërve, ne mund të ndihmojmë shumë fëmijët tanë nëpërmjet koherencës dhe qartësisë sonë. Pak nga pak rregullat përvetësohen dhe vlerësohen, për disa do të jetë më e lehtë e për disa të tjerë më e vështirë, por janë prindërit ata që i përcaktojnë rregullat dhe jo fëmijët!

Si dhe në çfarë moshe mund të shpjegohen ndryshimet seksuale midis meshkujve dhe femrave?

Fëmijët e bëjnë këtë zbulim për ndryshimin midis seksve edhe para se të flitet për këtë argument. Seksualiteti në vitet e para të jetës kuptohet si një kuriozitet fiziologjik në lidhje me këtë dallim, shpesh lind nga kureshtja për dallimet fizike dhe është e rëndësishme që fëmija të mund të shprehë kuriozitetin e tij lirisht pa befasuar shumë apo pa krijuar shumë ankth. Është e rëndësishme të shpjegohet me fjalët e përshtatshme dhe me qetësi se jemi ndryshe dhe se ky ndryshim është baza e jetës.

Si të zgjedhim tregimet për fëmijët e vegjël?

Historitë që u tregohen fëmijëve janë një mundësi veçanërisht të vlefshme për të favorizuar zhvillimin e të folurit dhe ne e dimë që ndihmojnë zhvillimin emocional, afektiv dhe të

njohurive. Janë një mundësi për të ndarë me prindërit ndjenjat dhe gjendjen e tyre shpirtërore: në fakt nëpërmjet personazheve fëmijët mund të mësojnë të njohin dhe të menaxhojnë edhe ndjenjat negative. Sidomos në vitet e para të jetës së fëmijës është mirë të zgjidhen tregime të shkurtra dhe me ilustrime shumë të qarta, të lehta për t'u kuptuar: tregime të vogla nga jeta e përditshme, ku imazhet mbizotërojnë mbi fjalët, për të vazhduar gradualisht drejt tregimeve që përmbajnë më tepër fakte. Fëmijët i duan përsëritjet, sepse ato bëjnë që ata të ndihen të sigurtë, lejojnë të kuptojnë gjithmonë e më mirë, duke arritur të parashikojnë ngjarjet që janë duke dëgjuar. Një tjetër gjë është të duash shumë tregime përpara se të shkosh në krevat, e cila është në fakt një mënyrë për të larguar momentin e ndarjes së natës, kështu që është mirë të bini dakord paraprakisht: një histori dhe pastaj puthjen e natës së mirë.

A është e gabuar t'i lejosh të shohin televizor?

Televizori është një mjet i rëndësishëm informacioni dhe nuk duhet trajtuar si diçka tepër negative edhe pse besohet gjerësisht se mund t'a përmbushi më mirë misionin e tij. Përsa i përket fëmijëve, nuk ka asnjë nxitim për të filluar! Pastaj kjo varet nga prindërit të zgjedhin programet dhe kohën që ata duhet të kalojnë përpara televizorit, duke kujtuar që mesazhi televiziv është "vetëm në një drejtim" dhe që publiku është pasiv. Është me rëndësi që prindërit gjithmonë të dinë se çfarë programesh shohin fëmijët e tyre dhe është e preferueshme ti shohin ato së bashku, në mënyrë që fëmijët mund të bëjnë pyetje dhe të marrin përgjigjet për mendimet që ata kanë.



Frikë dhe siguri

Të pyesim psikologun

Si t'ia bëjmë me problemet e gjumit?

Bebet e sapolindur janë të ndryshëm nga njëri-tjetri në rregullimin e gjendjeve në gjumë-zgjuar-ushqyerje-qarje, të cilat ndiqen ritmikiisht gjatë harkut kohor të përditshëm.

Gjumi, pa dyshim, që nga fillimi i jetës, është veçoria më personale e zakoneve tona.

Është normale të shohësh se ka foshnje që i kombinojnë më lehtë dhe në mënyrë spontane këto momente dhe ka të tjerë që kërkojnë më shumë ndërhyrje intensive nga të rriturit në mënyrë që të gjejnë hap pas hapi mënyrën e tyre të organizimit.

Ndoshta ka frikë nga gjumi?

Po. Fillon të kuptojë se të flerë do të thotë të humbasë kontaktin viziv, komunikimin dhe perceptimin me njerëzit dhe gjërat që është mësuar të frekuentojë gjatë ditës.

Gjumi përjetohet si një përvojë shkëputje nga çdo gjë që përbën burim kënaqësish, një detyrim për të ndërprerë vigjilencën mbi realitetin e jashtëm, pra si një lloj ndarjeje.

Çfarë mund të bëjmë për t'i qetësuar?

Fëmijët kanë nevojë të sigurohen për vazhdimësinë midis para dhe pas gjumit: ata duan të jenë të sigurtë për faktin se nuk do të ketë ndryshime të rëndësishme ndërsa flenë, duan të dinë se çfarë do të gjejnë kur të zgjohen.

Ja përse koha për të shkuar në shtrat është e veçantë nga ritualet që çdo fëmijë kërkon nga ana e të rriturve, në shtëpi dhe në çerdhe: tregimi apo përralla e zakonshme, renditja e njëjtë e veprimeve, objektet e njëjta, të njëjta ritme.

Gjëra të përsëritura, atëherë...

Ndonjëherë prindërve u duket i pakonceptueshëm fiksimi i ngurtë i fëmijëve për zakonet, ndërsa faktikisht është pikërisht kjo pandryshueshmëri e dukshme që përfaqëson bazën e sigurive emocionale. pse është nga kjo situatë që fëmijët gradualisht fitojnë sigurinë e të qenit në gjendje t'ia dalin

mbanë në mënyrë të pavarur e të eksperimentojnë dalë-ngadalë ndjenjën e autonomisë. Kjo vlen edhe për rregullimin e funksioneve të tyre biologjike.

Dhe kur të jenë me fëmijët e tjerë, do të jetë më e vështirë...

Është provuar shkencërisht se që nga muajt e parë të jetës, fëmijët janë shumë të motivuar për të njohur persona të tjerë: jo vetëm të rriturit por edhe bashkëmoshatarët e tyre. Ardhja në çerdhe do të thotë të gjendet mes shumë të tjerëve të barabartë me atë, me mënyra të sjelljes mjaft të ndryshme nga ato që fëmija ishte mësuar, por interesi shoqëror dhe ndjeshmëria që zhvillohen në mënyrë të parakohshme kundrejt moshatarëve të tyre, janë shumë frymëzues. Gjatë tre viteve të para gradualisht shokët bëhen një pikë tërheqëse dhe komunikimi i pazëvendësueshëm. Në çerdhe lindin miqësitë e para, përballjet dhe krahasimet mes moshatarëve të ngjashëm, por edhe konfliktet e para. E gjithë kjo u lejon të eksperimentojnë emocionet dhe të rregullojnë të qenit së bashku.

Më duket se disa momente të caktuara, si ndërrimi i pelenave, janë veçanërisht delikate...

Sigurisht, sepse trupi i foshnjës është thelbi i gjithë personit të tij. Cilësia e përvojës lidhur me personat që merren si referim, filimisht kalon pothuajse e gjitha nëpërmjet praktikave të kujdesit për nevojat themelore që lidhen me trupin. Në çerdhe, momenti i ndërrimit është një situatë e rëndësishme në të gjithë harku ditor, pikërisht për kuptimin themelor që i jepet praktikave fizike për zhvillimin mendor dhe emocional.

Por edhe momenti i ngrënies është i veçantë!

Ushqimi është një nga burimet themelore të kënaqësisë në të gjitha fazat e jetës dhe ushqyerja bashkë me të tjerët është në të gjitha kulturat dhe traditat (megjithë veçoritë) simbol i mirëqënies dhe përkatësive sociale. Mësimi i të ushqyerit vetë, është një nga arritjet më emocionuese: do të thotë që nuk varet më nga të tjerët. Kur arrin të ushqehet vetë, mbaron ajo marrëdhënia e veçantë me të rriturit që i çonin ushqimin deri te goja. Në çerdhe momenti i ngrënies është një palestër e rëndësishme për të mësuar aftësitë që u lejon të ndjehen të rritur dhe të pavarur përballë ushqimit.



Një tjetër moment i rëndësishëm është kalimi shtëpi/çerdhe. Një send personal i ndihmon, apo jo?

Kalimi nga shtëpia në çerdhe mund të përjetohet nga fëmija si një ndarje nga zakonet e përditshme që i siguronin qetësinë, dhe nga konteksti familjar i referimit. Kjo, në veçanti, vihet re para se fëmija të ketë mbushur 1 vjeç, kohë në të cilën nuk ka kuptuar ende se njerëzit dhe objektet që i pëlqejnë vazhdojnë të ekzistojë edhe kur nuk i ka para syve apo kur nuk u dëgjon zërin apo ndjen dorën.

Ndryshimet e mjedisit në vetvete nuk janë negative, por është e rëndësishme që fëmijët, kur përballen me një përvojë të re, të mund të përdorin disa objekte të preferuar (p.sh. një pellush, një shallë të nënës, etj) si një lloj "ure" që u lejon të ruajnë gjurmë të plota të vlerave emocionale që lidhen me jetën familjare.

Fëmija arrin të dallojë rregullat e shtëpisë dhe ato të çerdes?

Pa dyshim konteksti i jetës në grup, si ai në çerdhe, ndihmon përshtatjen ndaj rregullave sociale, ku përveç profesionalizmit të edukatorëve, një rol kyç luhet edhe nga sjellja imituese ndaj shokëve të tjerë. Imitimi, që nga muajt e parë të jetës, përfaqëson një karakteristikë të mrekullueshme që mbështet zhvillimin mendor, emocional dhe social.

Ndonjëherë mendoj se e kanë më të vështirë të na binden ne prindërve...

Në shtëpi mund të jetë më e vështirë për një sërë arsyesh: që nga lodhja e prindërve nga fakti se drejtimi i familjes kërkon një sërë detyrimesh e për pasojë nuk mund t'i kushtohen vetëm fëmijës, e deri te pritjet/kërkesat reciproke që karakterizojnë marrëdhëniet e çdo nëne/babai me fëmijën e vet. Për fëmijët, përvetësimi i aftësisë për të vetëvendosur rregulla kalon përmes të mësuarit të rregullave të propozuara fillimisht nga të rriturit dhe është kënaqësi e brendshme kur janë në gjendje t'i respektojnë ato, sepse bëhen të vetëdijshëm se po mësojnë të jenë me të vërtetë zotër të vetvetes.

Rregullat e çerdes i respektojnë më shumë!

Vendosja e kufijve, veçanërisht duke nisur që në vitin e dytë, nganjëherë mund të jetë e lodhshme për prindërit, krahasuar me kohën kur fëmija ishte shumë i vogël dhe përpiqeshin t'u

përgjigjeshin e kënaqnin kërkësat e tij. Por rritja, si nga pikëpamja emocionale dhe mendore, do të thotë gjithashtu edhe të mësuarit e rregullimit të impulseve të brendshme dhe pranimit të rregullave në mjediset të ndryshme shoqërore ku ndodhet.

Në çerdhe duket më i gatshëm për të dëgjuar të rriturit...

Në kalimin nga shtëpia në çerdhe fëmijët, pasi kalon periudha e ambientimit, janë mjaft të aftë të kuptojnë specifikat e secilit kontekst dhe vetë organizatës.

Kështu mund të ndodhë që prindërit t'a kenë të vështirë të besojnë se fëmija i tyre në një ambient të ndryshëm nga ai i zakonshmi, të jetë në gjendje të sillen në mënyra pothuajse të panjohura për ta, por është pikërisht kështu, sepse plasticiteti dhe fleksibiliteti i mendjes njerëzore është në aftësinë për të njohur dhe për t'u përshtatur konteksteve të ndryshme, duke filluar që nga muajt e parë të jetës.



Si është në çerdhe

Të pyesim edukatoren

Mjedisi i çerdhes është i bukur dhe i rregullt, por për fëmijën kanë më shumë rëndësi...

Është e vërtetë, për fëmijën afrimiteti i parë me mjedisin kalon nëpërmjet personave të referimit. Pikërisht për këtë, buzëqeshja e edukatores është "vendi" i parë ku përqendrohet. Nëse i vini re, fillimisht shikimi i fëmijës kalon nga njëra fytyrë e të rriturive në tjetrën, si të kërkonin konfirmim nëse mund t'u besojnë a jo; megjithatë besimi që do të jenë të gatshëm të japin, varet nga çfarë do i transmetojnë prindërit e tij/saj.

Një vend kaq i ndriçuar, ku mund të bëhen plot gjëra dhe i qetë. Një vend i cili duket se ka qenë menduar pikërisht për fëmijët.

Në fakt, mjediset janë menduar për nevojat e fëmijëve dhe për rritjen e tyre. Si dritat ashtu edhe ngjyrat e buta janë përgatitur për të dhënë një ndjenjë të këndshme e të qetë; ka hapësira të vogla dhe të mbledhura si dhe ato për të ndenjur me shokët, gjëra të vendosura në vende lehtësisht të arritshme dhe jo, sipas nevojës.

Më duket se pastërtia është shumë mirë, është e vërtetë?

Sigurisht. Ka standarde shumë të rrepta për mbajtjen e higjienës dhe pastërtisë, faktor i rëndësishëm në një komunitet edhe për të ruajtur shëndetin. Ka, për shembull, mbulesa për këpucët, ngjyrë blu, të cilat të rriturit i veshin për të hyrë nëpër dhomat e ndryshme, në mënyrë që të mos sjellin brenda në çerdhe papastërtitë e rrugës.

Për çfarë shërben ekspozimi i fotografive?

Në seicilin grup fëmijësh të çerdhes gjenden fotografi të ekspozuara dhe dosje për t'u shfletuar. Nëpër mure ato japin një ndjenjë përkatësie: "këtu jam edhe unë", nëpër albume janë kapur detaje, që mund të ndahen me një mik. Është bukur që fëmijët të shohin vehten e tyre në aktivitetet që kanë kryer, të thonë emrat e shokëve dhe gjëra të njohura.

Fotot e ekspozuara prezantojnë edhe çerdhen bashkë me stafin

dhe tregojnë përvojat që janë kryer në atë periudhë kohë. Prindërit mund t'i komentojnë bashkë me fëmijët, të cilët do të jenë të lumtur. Shpesh edhe fotografitë e mamit dhe babit janë në një libër të veçantë personal, sepse fëmijës i bën mirë të rishikojë familjen e tij herë pas herë, t'ia tregojë edukatores, të thotë diçka rreth tyre.

Duke pasur shumë dhoma, mund të ndihet i hutuar?

Përgatitja e ambienteve është menduar të njihet nga fëmijët për nga aktivitetet që në secilin prej tyre zhvillohet. Çdo gjë është e përshtatur për fëmijët dhe çdo detaj është e menduar për t'a ndihmuar fëmijën të përcaktojë momentet dhe t'i jetojë mirë ato. Të gjitha aktivitetet janë të organizuara për kohëzgjatje dhe për të qenë sa më të këndshme.

Praktikisht, si?

Çdo fëmijë shpenzon pjesën më të madhe të ditës me grupin e tij në një dhomë referimi, të organizuar në "kënde" të ndryshme: hapësira në të cilat është e mundur të lëvizësh, të lexosh, të luash shtëpiash, të ndërtoosh, etj. Ka gjithmonë një qoshe të butë të bërë nga jastëkë, dyshekët e mëdhenj dhe të mbushur mbi të cilët mund të shtrihesh, relaksohesh dhe të përkëdhelesh.

Kaq të vegjël sa janë, dinë si të luajnë me shumë vetë?

Çdo fëmijë bëhet pjesë e grupit, të *vogël* ose të *madh*, sipas moshës: zakonisht do të përbëhen nga 6 fëmijë deri 18 muajsh dhe nga 9 nga mosha 18 muajsh deri në 3 vjeç. Raporti midis fëmijës dhe të rriturit është i përshtatshëm për mundësinë e secilit të ndjejë të rriturin "për vete". Fillimisht fëmijët luajnë me dy, pastaj tre, duke mësuar mënyrat e bëra së bashku dhe gjithashtu duke kapërcyer konfliktet e vogla natyrale, si dëshira për të patur të njëjtën gjë në të njëjtën kohë.

Sa edukatore janë në raport me fëmijët?

Ne jemi mësuar kaq shumë me figurën e edukatores sa nuk konsiderojmë se ka edhe edukatorë meshkuj. Nuk është shumë e zakonshme, por figura mashkullore është një prani shumë e vlerësuar në çerdhe, edhe sepse përfaqëson realitetin e të dy prindërve. Megjithatë, çdo grup ka një edukatore si referencë, figura kryesore, ajo që është prezent në momentet më të rëndësishme të ditës, dhe është ajo që kujdeset për të

konsoliduar grupin e fëmijëve. Është, pra, ajo (ose ai) që pret për të parën intervistë, të cilës/it do t'i prezantoni fëmijën tuaj dhe zakonet e tij, që pastaj do t'ju informojë mbi përparimet e tij. Edukatori është pjesë e një grupi pune në të cilin bën pjesë edhe figura e koordinatorit/es së brendshëm/me, i cili/e cila njih të gjithë fëmijët e çerdhes dhe prindërit e tyre dhe që është gjithmonë në dispozicion për çdo informacion apo nevojë.

Për shkak se fëmijët kanë nevoja të ndryshme do të kenë edhe ritme të ndryshme...

Seksioni i të vegjëlve është më i qetë, fëmijët mund të zvarriten lirisht, të ecin këmba – dorazi, kush nga fëmijët e vegjël lëviz disa hapa me ndihmën e edukatores, një tjetër bën përpjekje për pozicionin ngritur "duke u ngjitur" në "hapat e tij të parë", një tjetër po fle i qetë mbi tapet... sigurisht nuk mungojnë edhe disa të qara, por në krahët e të rriturit kalojnë shpejt. Më i ngarkuar është seksioni i të mëdhenjve: fëmijët shkojnë me lehtësi në kërkim të lojrave të tyre të preferuara, ulen për të dëgjuar një tregim ose për të kënduar një këngë. Qoshet janë më të strukturuar dhe karakterizohen për nga qendrat e interesit, në mënyrë që të jenë stimuluese për të inkurajuar fëmijët që të bëjnë dhe provojnë.

Dhe kush kujdeset për përgatitjen e vakteve?

Në çdo çerdhe ka një kuzhinier apo kuzhinierë që gatuan për të gjithë fëmijët. Ushqimet përgatiten përditë pikërisht me duart e tyre, ushqimet janë të zgjedhura dhe të kontrolluara për të krijuar një menu në përputhje me urdhrat e tabelave dietike provinciale. Përkrah kuzhinierit/es punojnë edhe stafi mbështetës. Një prej tyre është gjithmonë i pranishëm në kuzhinë, ndihmon kuzhinierin të gatuaj, sjell tavolinën me vaktin e përgatitur. Të tjerët merren me vëniën në rregull dhe të pastrimit të të gjitha ambjenteve të çerdhes dhe madje edhe kopshtin e jashtëm.

Dhe pastaj në tryezë fëmijët ia dalin mbanë vetë sado pak, apo jo?

Fëmijët më të rritur bëjnë më rradhë "kamerierin" dhe së bashku me të rriturin shtojnë tavolinën. Momenti i vaktit është menduar dhe ndjekur me kujdes, kështu është më e lehtë për fëmijët që të afrohen qetësisht me pjatat që ende nuk i njohin, duke u përballur me shije të reja në një edukim të shijes që



ditë për ditë do të shtojë gjërat e pëlqyera. Disa fëmijë hanë çdo gjë, dikush tjetër ka pak më tepër vështirësi dhe kështu edukatorja shërben sasi të ndryshme dhe pastaj i le "të hanë vetë", duke kontrolluar, natyrisht; i fton të shijojnë atë çfarë ka, por pa i detyruar shumë. Për fëmijët më të vegjël, vakti zhvillohet në një mënyrë tjetër: edukatorja ulet në qendër të tavolinës gjysmërrethore kështu arrin t'i ndihmojë të gjithë. Edhe atyre që duhet të ushqehen u jepet një lugë për t'u mësuar me këtë mënyrë dhe për të filluar të jenë autonomë. Vakti është gjithashtu një mundësi për të promovuar socializimin dhe favorizuar bisedat e para midis fëmijëve, një moment për të ndarë shijet dhe fjalët e miqësisë.

Si janë të menduara lojrat?

Loja për fëmijën është aktiviteti kryesor, nuk është vetëm kënaqësi por edhe njohuri dhe komunikim. Ne mund të themi se fëmijët "luajnë të rriten". Në çerdhe eksperimentohen aktivitete specifike për moshën e tyre, edhe të ndryshme nga ato që bëhen në shtëpi: lëvizin, prekin, trazojnë, bëjnë rrëmujë, behen pis, vishen si personazhet e tyre të preferuar, bëjnë punime me dorë... Natyrisht, edhe në çerdhe duhet pastaj të vihet çdo gjë në rregull, është rregull i çerdhes, por që mund të shihet si një lojë. Propozimet e lojrave dhe të materialeve ndjekin një program edukativ të cilat marrin parasysh nevojat e fëmijës. Parashikohen përvoja me materiale natyrale dhe me objekte të pazakonta dhe të panjohura, me qëllim të stimulimit të kuriozitetit dhe të dëshirës për të eksploruar tek fëmija i vogël.

Ka edhe festa?

Sigurisht, dhe janë të bukura. Ndonjëherë ka evenimente të veçanta, si festat me prindërit ose një drekë në shoqërinë e fëmijëve më të mëdhenj të kopshtit. Ka raste kur ndodh gjithashtu, që grupe të vogla të prindërve, të ndihmuar nga edukatorët, përgatisin skena teatrale për fëmijët, të cilat janë gjithmonë një sukses i madh.

Sigurisht një fillim i mirë i ditës e bën gjithçka më të lehtë.

Kjo është e vërtetë si për fëmijët, ashtu edhe për të rriturit. Për këtë pritja dhe momenti i ndarjes trajtohen në mënyrë të

veçantë. Takimi me edukatoren zhvillohet gjithmonë në të njëjtin vend, në mënyrë që fëmija të ndihet i sigurt. Shkëmbimi i shkurtër i informacioneve, shikimet, marrëveshja midis të rriturve, do t'i japë fëmijës ato kufij afektive që i shërbejnë si mbështetje emocionale për largimin e prindit.

Pastaj janë aktivitetet e planifikuara?

Nga gjysma e mëngjesit propozohet një aktivitet i planifikuar, që ndryshon çdo ditë për secilin grup dhe zhvillohet në zona të veçanta ose në laboratorë specifikë: të lëvizjes, të punimeve me dorë apo pikturë... Mundësitë janë të përcaktuara qartë: argëtim, kreativitet, përvetësim të rregullave dhe aftësive. Në laboratorin e pikturës, për shembull, ka ngjyrat e të gjitha llojeve, për t'u përdorur me duar apo furça të madhësive të ndryshme për ngjyra në mur apo në tryezë, apo për të lënë mbi letër gjurmët shumëngjyrëshe të duarve apo këmbëve. Në sallën psikomotorike janë dyshekët, modulet e butë të bëra në formë shkalle, tuneli, cilindri, të cilat lejojnë të bëhet eksperiencë hedhesh dhe kapërdimje, të hysh dhe të dalësh, të qëndrosh në ekuilibër ose të biesh...

Merr pjesë i gjithë grupi?

Kjo varet nga lloji i aktiviteteve dhe objektivave që propozohen. Disa janë të organizuara për të gjithë grupin, disa të tjera për disa fëmijë për çdo herë. Në çerdhe nuk mungon kurrë parku i lojërave dhe shumë aktivitete zhvillohen jashtë, nga lojërat me dëborë deri tek ato në pishina të vogla, dhe ndonjëherë mund të hahet në hijen e çative.

Ata gjithashtu mësojnë të përgatiten për të bërë gjëra...

Para se të ulet në tryezë edukatorja shoqëron fëmijët për të larë duart dhe gjatë ditës, ka disa momente të kushtuara këmbimit dhe kujdesit të trupit. Edukatorja emëron gjestet që bën dhe, duke bërë kështu, i lejon fëmijës të ndjekë veprimet dhe të bëjë lidhjen me trupin e tyre, i cili dalë ngadalë merr formën dhe kufijtë edhe në mendjen e tyre.

Momenti i pushimit është i njëjtë për të gjithë?

Koha e secilit respektohet dhe më të vegjëlit mund të flenë edhe në mëngjes ose kur ata kanë nevojë në çdo moment të ditës. Pas vaktit çdo fëmijë përgatitet për të shkuar në dhomën e gjumit dhe në krevatin e tyre. Në çerdhe janë parshikuar

dhoma gjumi për të vegjëlit dhe për më të mëdhenjtë, ka shtretër të ulët, me anët e krevatit apo kokat e tij, në të cilët ka gjithmonë një objekt, një lodër pellushi apo diçka të dashur e sjellë nga shtëpia e cila ndihmon për t'u çlodhur dhe të flejë gjumë.

Dhe pas zgjimit?

Pas zgjimit, fëmijët shkojnë në tualet, ku një edukatore i ndryshon pelenën, i ndihmon ata që të vishen, të krihen, të vendosin kremin. Pastaj, fëmijët shkojnë përsëri në dhomën e tyre dhe dikush do të nisë menjëherë lojërat dinamike apo dikush tjetër që preferon ende disa minuta qetësie më shumë në krahët e edukatores. Nga mesi i pasdites dhe para ardhjes së ndonjë prindi, mblidhemi të gjithë së bashku për një meze të lehtë.

Kur mbërrijnë prindërit e tjerë dikush mërzhitet shumë?

Jo, sepse për secilin ka shumë kujdes. Kushdo që mbetet ende mund të luajë së bashku me edukatoren e pasdites që ka të tjera propozime për të, asgjë të vështirë ose të strukturuar, vetëm lojëra me temë të lirë dhe relaksuese.

Dhe nëse do të ishte "i zemëruar" për mungesën time?

Momenti i ribashkimit është një pasazh delikat dhe plotë shpresa, si për fëmijën ashtu edhe për prindin. Ndonjëherë fëmija mund të tregojë rezistencë për të lënë lojën ose shokët, por edukatorja do të zgjidhë gjithçka duke përdorur fjalët më të mira.



Çerdhet në Trentino

Struktura dhe organizimi

Çfarë lloje çerdhesh ka në Trentino?

Provinca e Trentos ka promovuar një "sistem të shërbimeve socio-edukative për fëmijërinë e hershme" që përfshin disa lloje: çerdhet për fëmijë, çerdhet për fëmijë në vendin e punës, çerdhet familjare shërbimi - tagesmutter si dhe shërbimet shtesë. Ideja është t'u sigurohet familjeve një shumëllojshmëri mundësish socio-edukative, dhe mbështetja në rolin e tyre edukativ, si dhe përhapjen në shoqëri të një kulture të respektit dhe kujdesin ndaj fëmijëve.

Çerdhet janë më historike

Mirë se vini në çerdhe paraqet çerdhen për fëmijë, elementin kyç të instalimit të shërbimeve dedikuar fëmijëve 0-3 vjeç, më i përhapuri dhe historik që ekziston prej më shumë se 40 vjet. Në fakt, çerdhet e para publike janë shfaqur nga mezi i viteve '70, fillimisht në qendrat më të mëdha më pas duke u përhapur edhe në lugina.

Parashikuar në Itali nga një ligj i vitit 1971

Shteti miratoi të parin dhe të vetmin ligj, l. n.1044, i vitit 1971, që përmban rregulla të përgjithshme, nga e cila pasuan Ligjet specifike rajonale. Në Trentino në vitin 1978 u miratua ligji n. 13, i cili u pasua nga l. n. 4 i vitit 2002, me modifikimet e mëpasshme. Sot çerdhet e pranishme në provincë janë 85, për një total prej 3.131 vendeve (shifrat Janar 2012).

Marrim nga ligji disa koncepte kyçe:

shërbimi arsimor që kontribuon në edukim

"Çerdhet janë një shërbim arsimor dhe social për fëmijët nga 3 muajsh deri në 3 vjeç. Ato kontribuojnë me familjet në rritjen dhe edukimin e vajzave dhe djemve në respekt të identitetit individual, kulturor dhe fetar duke siguruar të gjithëve edukimin, kujdesin dhe socializimin në funksion të mirëqenies së tyre psikofizike dhe të zhvillimit të potencialeve të tyre njohëse dhe afektive".

sistemi i shërbimeve

Sistemi i shërbimeve është tërësia e shërbimeve që janë prezent në territor dhe ka për qëllim sigurimin e një cilësie të lartë dhe uniforme në të gjithë territorin e provincës. T'i përket këtij sistemi është një garanci që siguron përdoruesit mbi faktin që të gjitha shërbimet sociale dhe arsimore ofrojnë të njëjtat garanci, si përshembull: e drejta e hyrjes në çerdhe për moshën e përcaktuar, hyrjes dhe integrimin e fëmijëve me aftësi të kufizuara apo në situata disavantazhi social dhe kulturor, homogjeniteti i titujve akademikë të stafit ose trajnimi i përgatitur për to, veprimet e vazhdimësisë me kopshtin.

menaxhimi

Çerdhet në Trentino janë publike dhe janë të menaxhuara nga Komunat, të cilat sigurojnë shërbimin për të gjithë fëmijët që banojnë në territorin e saj.

Komunat mund të zgjedhin 2 mënyra menaxhimi:

- e drejtpërdrejtë, domethënë, me stafin e saj
- indirekte, nëpërmjet besimit të menaxhimit kooperativave sociale. Në këtë rast ato do të sigurojnë rekrutimin e stafit dhe funksionimin, por Komuna do të qëndrojë titullari i shërbimit, garantuesi i një funksionimi të kënaqshëm si dhe referenti për qytetarët.

organizimi

Komunat gjithashtu kujdesen edhe për organizimin e shërbimeve. Ajo përbëhet nga faza të ndryshme që shkojnë nga programimi i planit të zhvillimit të shërbimeve që do të aktivizohen, te përgatitja e projekteve për t'u realizuar, deri në menaxhimin e tyre. Ekziston edhe një fazë operative që parashikon forma të koordinimit dhe bashkëpunimit midis shërbimeve, të pjesëmarrjes së familjeve në zgjedhjet edukative apo arsimore, të propozimeve për institucionin kompetent, të aktiviteve të trajnimeve për stafin.

pjesëmarrja ekonomike

Është përgjegjësi e komunave të përcaktojnë kriteret për pjesëmarrjen ekonomike të përdoruesve duke respektuar kushtet socio-ekonomike dhe kapitalin e familjeve.

competencat

Përveç komunave, edhe Provinca merr pjesë gjithashtu në

zhvillimin e shërbimeve për fëmijët në çerdhe me aktivitete programimi të nivelit provincial dhe iniciativa në nivele të ndryshme:

- strukturor dhe organizativ: përcakton kushtet dhe standardet minimale të shërbimeve, numrin minimal dhe maksimal të tyre dhe marrëdhënien edukator / fëmijë;
- promovuese dhe kulturore: me iniciativa për përhapjen e kulturës së fëmijërisë, aktivitet kërkimi dhe dokumentacioni për të nxitur njohjen dhe vëmendjen për fëmijët;
- cilësore dhe pedagogjike: me aktivitet koordinimi, pranimi dhe trajnimi të personelit.

trajnimi:

Trajnimi i edukatorëve është një nga treguesit e cilësisë së shërbimeve arsimore dhe ka një përkujdesje të veçantë nga Provinca. Dy janë ndërhyrjet që ofrohen çdo vit:

- një në nivelin e përgjithshëm nën kujdesin e Provincës që, duke pasur kompetencë kryesore në këtë fushë, zhvillon një program trajnimi për të gjithë stafin që punon në arsim apo që punojnë në shërbimet që i përkasin sistemit. Ky plan është përcaktuar në bazë të propozimeve të rena dakord me ata që menaxhojnë shërbimet dhe përfshin aspektet organizative, për funksionimin e monitorimit dhe verifikimit;
- një i promovuar në mënyrë të pavarur nga secili subjekt drejtues të personelit të çerdheve të qeverisura prej tyre.

Koordinimi pedagogjik:

Çerdhet përfitojnë dy lloj koordinimi pedagogjik:


- Koordinimi i sistemit, varet nga Provinca, për siguruar, nëpërmjet ndërhyrjeve dhe kontakteve sistematike me drejtuesit, kualifikimi dhe konsistenca e shërbimeve në territor;
- Koordinimi i strukturës që varet nga secili subjekt drejtues dhe ka funksionin e menaxhimit të brendshëm, drejtimin e grupeve të punës dhe përgatitjen e projekteve arsimore.

Realiteti i një sistemi kapilar

Sistemi i shërbimeve me çerdhet, shërbimet plotësuese dhe çerdhet familjare është rritur shumë në vitet e fundit, të dhënat e muajit Janar 2012 shënojnë praninë e: 85 çerdheve, 2 shërbimeve plotësuese, 3 çerdheve nëpër ndërrmarje, rreth 80 çerdheve familjare.



Hapësirë personale





F.I.O.R.E.
FAMIGLIA, INFANZIA,
ORIENTAMENTI,
RIFLESSIONI EDUCATIVE
0-3 ANNI